



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**P.nr.1032/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Bute Noci, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: A. M. nga ....., rruga “.....” nr.10, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1238/174 të datës 04.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt. 11.11.2019, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha, të akuzuarve dhe të dëmtuarës A. Halili -Ademaj, ndërsa me datë 13.11.2019 murr dhe shpalli dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Kundër të akuzuarit:**

**A. M.**, i lindur me ....., në fsh, ..... K. .... nga babai A. dhe nëna H. e lindur M., me vendbanim në Pejë rr. “.....”, nr.10, ka të kryer shkollën e lartë të maxhinerisë, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i gjenjdes së mesme ekonomike, i identifikuar sipas lnj. me nr. personal ....., lëshuar nga MPB –Prishtinë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

- Me datën 17.05.2017, rreth orës 11:13, në Pejë, në Gjykatën Themelore në Pejë, seriozisht kanosin personin zyrtar, juristen e AKP-së, A. H. - A., në atë mënyrë që e dëmtuara pas seancës gjyqësore, me të dalur në koridor të gjykatës deri sa kishte qenë me avokatin mbrojtës të tëdysshuarve, i afrohet i pandehuri F. M., duke ia drejtuar gishtin afër fytyrës duke i thënë “pse po qesh, kush je ti që po qesh a e din çka je duke na bërë neve, kush je ti që pronën tonë me na marr”, pas këtyre fjalëve ndërhyjnë i pandehuri A. M. duke e kërcënuar të dëmtuarën me fjalët, të ngrehi zhag, se ti dhe ajo kolegja jote M. duke bërë këtë punë, kush je ti që bytha jote me na bërë këtë, nuk guxon me e shkelë tokën e ....., keni me ma pa sherin ti dhe familja jote, ta njoh burrin etj.,... ku tek e dëmtuara krijohet frikë e shqetësim se do ti ndodhë diçka,

-me çka ka kryer vepër penale *kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par.1 nën par. 1.2, 49, 50, 51, 52, 53, 73, 74, dhe neni 185 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe neni 245, 246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

Duke ja pëcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një (1) viti, nuk do të kryen vepër tjetër penale.

I akuzuari obligohet të paguaj, shpenzimet për paushallin gjyqësor, shumën prej pesëdhjetë (50) euro dhe taksën në shumë prej tridhjetë (30) euro, për kompensimin e viktimave të krimit, krejtë këtë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmrisë së aktgjykimit.

E dëmtuara A. H. - A.nga ....., Rr. “.....” kati i ..... hyrja nr.6, për realizimin e kompensimit të dëmit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## **Ndaj të akuzuarit**

**F. M.**, i lindur me dt. ...., nga babai A. dhe nëna Gj. e gjinisë Sh., me vendbanim në rrugën “.....” nr.10, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtarë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., lëshuar nga MPB-Prishtinë, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**konform neni 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së**

## **REFUZOHET AKTAKUZA**

### **Gjëja se:**

-Me datën 17.05.2017, rreth orës 11:13, në Pejë, në Gjykatën Themelore në Pejë, seriozisht kanosin personin zyrtar, juristen e AKP-së, A. H. - A., në atë mënyrë që e dëmtuara pas seancës gjyqësore, me të dalur në koridor të gjykatës deri sa kishte qenë me avokatin mbrojtës të dyshuarve, i afrohet i pandehuri F. M., duke ia drejtuar gishtin afër fytyrës duke i thënë “pse po qesh, kush je ti që ppo qesh a e din çka je duke na bërë neve, kush je ti që pronën tonë me na marr”, pas këtyre fjalëve ndërhyjnë i pandehuri A. M. duke e kërcënuar të dëmtuarën me fjalët, të ngrehi zhag, se ti dhe ajo kolegja jote M. duke bërë këtë punë, kush je ti që bytha jote me ma bërë këtë, nuk guxon me e shkelë tokën e ....., keni me ma pa shtetin ti dhe familja jote, ta njoh burrin etj.,... ku tek e dëmtuara krijohet frikë e shqetësim se do ti ndodhë diçka,

-me çka në bashkveprim kishin për të kryer vepër penale të kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Për shkak se, prokurori i shtetit ka heq dor nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1238/174 të datës 04.10.2017, ndaj të akuzuarve, A. M.dhe F. M., që dy nga ....., për shkak se në bashkëveprim për të kryer veprë penale të kanosjes nga neni 185 par.3 e lidhur me par.1 dhe neni 31 të KPRK-së.

Meqenëse, prokurori i shtetit, ka hjek dorë nga i pandehuri F. M., gjykata ka refuzuar aktakuzën konform nenit 363 të KPPRK-së dhe arsyet në vijim do ti paraqes vetëm ndaj të pandehurit që ka mbetur pranë akuzës A. M..

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt. 11.11.2019 në të cilin e ka njoftuar të akuzuarit lidhur me të drejtat e tij konform nenit 323 të KPPRK-së. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores, në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe pasi që gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën, të akuzuarve ju ka dhënë mundësinë që të deklarohen lidhur me pranimin apo mos pranimin e fajësisë. Me këtë rast të akuzuarit kanë deklaruar se, pasi që i kanë kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë deklarohen të pa fajshëm për veprën penale me të cilën ngarkohen, pas kësaj gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me procedurën e provave.

### Fjala përfundimtare

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: gjatë shqyrtimit gjyqësor, patëm rastin ta dë gjojmë të dëmtuarën, dëshmitarin si dhe të pandehurit ku me marrjen në pyetje të dëshmitarit i cili ishte prezent ditën kritike, u vërtetua se i dyshuari këtu i pandehuri F. M., nuk ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale për shkak se atë ditë i njëjti nuk i kishte thënë asnjë fjalë të dëmtuarës dhe përpos deklaratës së të dëmtuarës ne nuk kemi asnjë provë tjetër për të dëshmuar fajësinë e tij andaj duke u bazuar në nenin 262 të KPPRK-së, si dhe në parimin IN DUBIO PRO REO, ku mëdyshjet lidhur me fajësinë e të pandehurit shkojnë në favor të të njëjtit heq dorë nga aktakuza PP.II.nr.për të pandehurin F. M., ndërsa sa i përket të pandehurit A. M., në mënyrë të plotë u vërtetua se është kryes i veprës penale për të cilën pandehet se i njëjti ditën kritike e kishte kanosur me fjalë të dëmtuarën, i njëjti gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor mohoi ta ketë kryer veprën penale gjykatës i propozoj që deklaratës së të njëjtit mos t'ia fal besimin pasi që ka për qëllim ikjes nga përgjegjësia penale dhe i propozoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligon në pagimin e shpenzimeve procedurale.

E dëmtuara, në fjalën e saj përfundimtare, ka deklaruar se: në tërësi e përkrah fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit.

I pandehuri A. M., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk e ndien veten fajtor, unë nuk kam pas kurrëgjë me këtu të dëmtuarën, por e kam mbrojt pronën time nga AKP-ja, unë të dëmtuarës i kam kërkuar falje për shqetësimin, në këtë rast unë jam viktimë se unë i kam humd 100.000 euro nga AKP-ja.

Meqenëse, prokurori i shtetit, ka hjek dorë nga i pandehuri F. M., gjykata ka refuzuar aktakuzën konform nenit 363 të KPPRK-së dhe arsyet në vijim do ti paraqes vetëm ndaj të pandehurit që ka mbetur pranë akuzës A. M..

### Gjendja e vërtetuar faktike.

Gjykata pas analizimit të provave dhe vlerësimit të tyre të gjithanshëm, secilës veç e veç e në lidhje reciproke me provat tjera, konform nenit 361 par.1 2 të KPPRK-së, dhe pas vlerësimit të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike.

- Se me datën 17.05.2017, rreth orës 11:13, në Pejë, në Gjykatën Themelore në Pejë, seriozisht kanosin personin zyrtar, juristen e AKP-së, A. H. - A., në atë mënyrë që e dëmtuara pas seancës gjyqësore, me të dalur në koridor të gjykatës deri sa kishte qenë me avokatin mbrojtës të të dyshuarve, i afrohet i pandehuri F. M., duke ia drejtuar gishtin afër fytyrës duke i thënë “pse po qesh, kush je ti që po qesh a e din çka je duke na bërë neve, kush je ti që pronën tonë me na marr”, pas këtyre fjalëve ndërhyjnë i pandehuri A. M. duke e kërcënuar të dëmtuarën me fjalët, të ngrehi zhag, se ti dhe ajo kolegja jote M. duke bërë këtë punë, kush je ti që bytha jote me ma bërë këtë, nuk guxon me e shkelë tokën e Pejës, keni me ma pa sherin ti dhe familja jote, ta njoh burrin etj.,... ku tek e dëmtuara krijohet frikë e shqetësim se do ti ndodhë diçka.

Kjo gjendje faktike u vërtetua edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve: A. U. H., S. B., si dhe janë administruar këto prova materiale, raporti i policit H. K. i dt. 19.05.2017, procesverbali i shqyrtimit publik i dt. 17.05.2017, kërkesa për iniciimin e procedurës për shkak të kanosjes ndaj zyrtares së AKP-së e dt. 18.maj 2017, si dhe shkresat tjera të lëndës dhe së fundi është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit.

#### Administrimi i provave

Nga raporti i policisë i dt. 19.05.2017, është vërtetu se, e dëmtuara A. H. - A., si zyrtare ligjore pranë AKP-së, pasi kishte përfunduar seancën gjyqësore në një çështje civile, së bashku me av. S. B. kishin dalur në korridorin e gjykatës, ku të akuzuarit A. M., i është drejtuar të dëmtuarës me fjalët kërcënuese, ta njoh burrin dhe familjen etj. Ku kishte ndërhy av. S. B. duke e qetësuar situatën që mos të sulmohej e dëmtuara nga i dyshuari, e kjo përputhet edhe me deklaratën e të dëmtuarës dhe të dëshmitarit.

Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i dt. 17.05.2017, gjykata ka vërtetua se, paraprkisht e dëmtuara, dëshmitari dhe i akuzuari A. M. dhe F. M., kishin marr pjesë në një gjykim për një çështje civile tek gjyqtarja G. P., ku me të dal nga seanca në korridorin e gjykatës e duke zbritur shkallëve teposhtë në gjykatë, kishte ndodh fjalosja në mes tyre, e kjom përputhet me deklaratat e të lartcekurve.

Nga kërkesa e për iniciimin e procedurës për shkak të kanosjes ndaj Zyrtares Ligjore të AKP-së e dt. 18.05.2017, vërtetohet se, e dëmtuara A. H. - A., punon si zyrtare ligjore pranë AKP-së, e cila ditën ishte kërcënuar dhe ofenduar nga i akuzuari A. M..

Gjykata, duke u bazuar në këto dëshmi –prova materiale, për të cilat nuk ka dilema për faktet të cilat janë vërtetuar, këtyre provave ju fali besimin e plotë, e të cilat janë në lidhje logjike dhe reciproke me njëra tjetrën.

E dëmtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici dhe prokurori, duke shtuar se, ka marr pjesë në seancën gjyqësore në një çështje civile tek gjyqtarja G. P., në cilësinë e zyrtares ligjore me autorizim për përfaqësim të AKP-së, në çështjen civile me bazë juridike vërtetim pronësie në mes ndërmarrjes shoqërore “.....”, si paditëse ndaj të paditurve NTSHP Kushineta, me pronar A. M.. Në çështjen civile të njëjtit kanë qenë të përfaqësuar nga av. S. B. dhe pas përfundimit të shqyrtimit duke pritur

për të nënshkruar procesverbalin e asaj seance, në ndërkohë e dëmtuara dhe avokati kanë biseduar për një çështje të tretë dhe kanë qeshur, pasi kanë dal në korridor të kësaj gjykate ka filluar A. M. dhe djali i tij F., ta fyejnë me fjalë këtu të dëmtuarën, kjo situatë kishte ndodh në pushimoren në mes të katit të dytë dhe të tretë, pasi që ishin duke zbritur shkallëve teposhtë. Që të dytë përnjëherë i janë kanë drejtuar të njëjtës, me fjalët fyese, kërcënuese dhe i kujtohet se e kanë përmend edhe .....-në, dhe aty afër ishte edhe avokati S. B., i cili ka dal para saj për ta mbrojtur nga të njëjtit, dhe lëndën nga çështja civile, të cilën e kishte në dorë avokati ua kishte kthyer këtu të akuzuarve. Të njëjtit ju kanë drejtuar me fjalët “pse po qesh, kush je ti që po qesh me neve, a e din ti se çka na ke ba”, në ndërkohë ka ndërhy A. me fjalët “të ngrehi zhag”, se ti edhe ajo koloegia jote M., jeni duke dasht me na marr pronën, by ...jote po don me marr pronën, kush jeni ju që ma bëni këtë, unë kam luftu për këtë vend”. Në ato momente ka ndërhy avokati S. B., e ka qetsu situatën, ndërsa të akuzuarit kishin vazhdu shkallëve teposhtë. E dëmtuara dekalron duke shtuar se, ka shkuar tek zyrtarët e sigurimit dhe ka kërkuar se a ka mundësi që ta sheh kamerën lidhur me rastin që ka ndodh, por punëtori i sigurimit, i është përgjigj se, në pjesën që ka ndodh rasti nuk filmohet nga kamera. Pas kësaj ka shkuar e ka pi një kafe dhe kam shkuar në vendin e punës, e ka lajmëruar menaxhmentin, i cili e ka sugjeru që rastin ta lajmëroi në polici. Shton se, qe 15 vite e ushtron këtë detyrë në AKP, duke marr pjesë si përfaqësuese ligjore në të gjitha gjykata në Kosovë, sipas detyrës zyrtare dhe asnjëherë nuk i ka ndodh ndonjë problem si në aspektin profesional dhe në aspektin privat.

Më tutje ka deklaruar se, është hera e parë që i ka ndodh një gjë e tillë dhe e ka ndie veten të kanosur, të rrezikuar, për këtë ju ka treguar edhe familjarëve në shtëpi, sa i përket fjalëve nga ana e të Akuzuarit A. M., i cili në mes tjerash ka thënë se “keni me ma pa sherrin ti dhe familja e juaj, ta njoh burrin etj”, e ka kuptuar si kërcënim serioz, ngase i njëjti është thirr në ..... dhe e ka përmend edhe nënën e tij, që i ka vesh pesë ushtarë për këtë vend, e duke i pas parasysh të gjitha këto e ka ndie veten seriozisht të kanosur dhe të frikësuar, nuk ka bërë lëvizje të shpeshta, nuk ka frekuentuar në vende publike dhe deri më sot i akuzuari nuk ka kërku falje.

Gjykata vlerësoi deklaratën e të dëmtuarës të dhenë si në polici, prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, të njëjtës dëshmi gjykata ia fali besimin e plotë, nga se deklaratat e saja përputhen njëra me njëra tjetrën por edhe me provat nga shkresat e lëndës, pasi që si e dëmtuara po ashtu edhe dëshmitari në detaje kanë sqaruar se, paraprakisht se kishin marr pjesë në një gjykim në një çështje civile, ku që të dy njëjtë kanë deklaruar se aty ka pas mosmarrëveshje në mes te të dëmtuarës dhe të akuzuarve, me ç’rast ka ndërhy këtu dëshmitari av. S. B., i cili ka deklaruar se ka dëgjuar A.un ti ketë thënë se, “unë e njoj A.dhe ia dij shtëpinë”, si dhe fjalët “të njoh ty dhe ta njoh burrin” me ç’rast e ka kritikua klientin e tij (A.), ku i njëjti nuk është ndal duke folur, nga të cilat fjalë, e dëmtuara është ndie e kërcënuar, e frikësuar për çka edhe e ka njoftua familjen e saj.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar edhe dëshmitarin – av. S. B. nga ....., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se: të dëmtuarën A. H. A. e njeh, lidhur me rastin konkret, data e sakt nuk i kujtohet, por të akuzuarin A. e ka pas palë, të cilin e ka përfaqësuar, në cilësi te të paditurit për një çështje pronësie, lidhur me disa bodrume të disa lokaleve afariste dhe sipas padisë së paditëses AKP-së, e të cilën e ka përfaqësuar në këtë rast e dëmtuara. Sa i kujtohet rasti ka qenë tek gjyqtarja G. P. dhe po ashtu sa i kujtohet ka qenë seanca e tretë që e ka përfaqësuar të akuzuarin A.. Ditën kritike gjatë seancës, A. ka filluar të ndërhyj dhe ia ka tërhequr vërejtjen të mos ndërhy, sepse ishte avokat i tij dhe nuk ka

pas nevoj. Sipas mendimit të tij, A. është person i një temperamenti të tillë që ka filluar të flas me një ton më të lartë ‘e njof A. dhe ia di shtëpinë’. Dëshmitari shton se përsëri e ka kritikua klientin e tij, se nuk mund të sillet në këtë mënyrë, duke ju drejtuar të akuzuarit A. “se unë jamë këtu me e përfaqësu anën juridike”, i akuzuari A. nuk është ndal dhe ka filluar të flas, ndërsa e dëmtuara A. e ka ndie, si një shqetësim në formë të kërcnimit. Është ndërpre gjykimi, kanë zbritur shkallëve dhe përsëri A. ka folë me një ton të lartë dhe duke zbrit shkallëve, këtu dëshmitari i ka thënë se, “nëse mua më ke besu përfaqësimin, nuk ke nevojë të krijosh kësi lloj tollovi”. Po ashtu edhe e dëmtuara ka qenë duke zbritur së bashku me këtu të akuzuarin, A. dhe F. si dhe dëshmitarin dhe i njëjti është munduar që ta qetësoj të dëmtuarën. Më tutje shton se, “deklaroj me përgjegjësi se, i akuzuari A. nuk ka sha, nuk ka fye dhe ka përdor vetëm fjalën se “unë të njoh dhe ta di shtëpinë” si dhe fjalët “të njoh ty, ta njoh burrin”, por jo edhe fjalët “të ngrehi zhag, apo keni me ma pa sherrin”, këto fjalë nuk i ka dëgju.

Sa i përket të akuzuarit F. , e pohon se e ka dëgjuar të njëjtin duke i thënë të dëmtuarës “pse po qesh, kush je ti që po qesh, kush je ti që don me na marr pronën. Në mes tjerash, ka sqaruar se, është munduar ta qetësoj të dëmtuarën pasi që e njëjta ka qenë e shqetësuar dhe e ka kuptuar shumë serioze këtë situatë. Prezent ka qenë edhe këtu i pandehuri F. i, i cili asnjë fjalë nuk e ka fol kur kanë zbritur shkallëve. Ndërsa sa i përket çështjes nga ana e Antigones, nuk ka pas të bëjë me të pandehurit sepse nuk ka pas asnjë arsye me qesh me ta, e për më tepër ai ka qenë edhe palë e këtu dëshmitarit, por i akuzuari A. atë ditë ka fol me ton të lartë edhe në seancë edhe deri sa kanë zbritur shkallëve. Sa i përket fjalëve se, F. i i ka thënë të dëmtuarës, “pse po qesh ti me baben tem”, dëshmitari deklaroi se, nuk e kam dëgjuar këtë fjalë, po ti kisha dëgjuar këto fjalë pa kurrfarë hezitimi do ti kisha thënë këtu para gjykatës.

Gjykata dëshmisë së dëshmitarit S. B. av. në Pejë, të dhënë para gjykatës ja fali besimin e plotë, meqë ishte i qartë dhe bindës dhe në hollësi e ka spjeguar rrjedhën e ngjarjes kritike, pasi ishte dëshmitar okular, e duke pas prasysh faktin se, dëshmitari e dëmtuara dhe të dy të pandehurit, paraprakisht kishin marr pjesë në një gjykim në një çështje civile, ku i njëjti ishte përfaqësues i autorizuar dhe e ka përcjellur ngjarjen për së afërmi dhe se asnjë fjalë kërcënuese nuk ka dëgjuar nga F. M., sa i përket të akuzuarit A. M., dëshmitari ka pohuar se, ka dëgjuar A. un ti ketë thënë se, “unë e njof A. dhe ia di shtëpinë”, si dhe fjalët “të njoh ty dhe ta njoh burrin” me ç’rast e ka kritikua klientin e tij (A.), ku i njëjti nuk është ndal duke folur, nga të cilat fjalë, e dëmtuara është ndie e kërcënuar, e frikësuar për çka edhe e ka njoftua familjen e saj dhe pas kësaj ngjarje, i njëjti është munduar ta qetësoj të dëmtuarën.

I akuzuari A. M. gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici, duke shtuar se, unë nuk e kam prek, as sha të dëmtuarën, ngase nuk kam pas asgjë me të, por me AKP-në. Unë të dëmtuarës është e vërtetë se i kam thënë, pse po qesh dhe kush jeni ju që doni me ma marr pronën, e njëjta më ka fol diçka por nuk më kujtohet me ma hjek kryet, nuk e di çka më ka thënë. Prej asaj dite nuk e kam pa të dëmtuarën në seanca, AKP-në e ka përfaqësuar një mashkull.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuari A. M., i cili mohon kryerjen e veprës penale, mirëpo të njëjtën mbrojtje gjykata e hodhi poshtë si të pa bazuar, duke qenë se i akuzuari e mohon të ketë kryer veprën penale, edhe pse nuk e konteston se i ka thënë fjalët “pse po qesh dhe kush jeni ju që doni me ma marr pronën”, mirëpo nuk i kujtohet se çfarë fjalë tjera kërcënuese i ka thënë të dëmtuarës, mirëpo kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia penale, duke pas parasysh se gjendja faktike është vërtetuar nga deklarimi i të dëmtuarës, dëshmitarit si dhe provat materiale të cekura më lartë.

Siç shifet nga mbrojtja e të akuzuarit, por edhe nga shkresat e lëndës dhe sipas provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, është vërtetë se i akuzuari, në mënyrë të kundërligjshme ka përdor fajlë kërkënuese ndaj të dëmtuarës, përm çka e njëjta e ka ndie veten seriozisht të kanosur dhe të frikësuar, nuk ka bërë lëvizje të shpeshta, nuk ka frekuentuar në vende publike.

Nga këto arsye, gjykata ka gjetur se mbrojtja e të akuzuarit është e orientuar në shmangie të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, nga se nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike si është përshkruar në këtë aktgjykim, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, i akuzuari ka vepru me dashje duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të veta dhe duke e dëshiruar shkaktimin e pasojave të cilat edhe i realizon, andaj gjykata të njëjtin e gjeti fajtor dhe penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale në fjalë.

Në rastin konkret, gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do të ishte me ndikim për zvogëlimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, prandaj i njëjti shpallet fajtor për veprën penale nga dispozitivi i aktgjykimit.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar faktin se, është kryefamiljar, baba i gjashtë fëmijëve, i vetmi mbajtës i familjes. Si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh se rasti në fjalë ka ndodh në lokalet e Gjykatës Themelore në Pejë. Në prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe rrethane rënduese, të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është bindur se vendimi mbi dënimin, do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar gjatë kësaj procedure penale.

Gjykata ndaj të akuzuarit F. M., konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, murr aktgjykim refuzues pasi që prokurori i shtetit hjeqi dorë nga aktakuza.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPRK-së, është vendosur si nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

**P.nr. 1032/17**

**Zyrtarja ligjore**

Bute Noci

**G j y q t a r j a**

Florije Zatriqi

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, pala ka të drejtë të parashtroj ankes, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.